

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“RENTIUM” SH.P.K

Me vullnetin tim të lirë, të shprehur edhe me nënshkrimin e këtij akt-themelimi në cilësinë e ortakut të vetëm, unë:

- Znj. Ana Kotte, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë, më 01/12/1994, mbajtës i ID nr. J46201052S, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

krijoj sot më datë 02.12.2022 shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “RENTIUM” SH.P.K me akt themelimi si vijon:

Akt Themelimi i shoqërisë tregtare “RENTIUM ” SH.P.K është i mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 1

Forma dhe emri i shoqërisë

Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “RENTIUM” SH.P.K. Shoqëria do t’i nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do t’i nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

Neni 2

Selia e Shoqërisë

Selia e shoqërisë “RENTIUM” SH.P.K do të jetë në: Rr. “Vaso Pasha”, Nd. 17, H. 9, Ap. 26, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 3

Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e mëposhtme:

- Qiradhënie e automjeteve të të gjitha llojeve; ngritja e rrjetit të qiradhënies së automjeteve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Dhënia e automjeteve të të gjitha llojeve me qira financiare;
- Ofrim shërbim taksie;
- Import, eksport të produkteve të të gjitha llojeve, automjeteve, pjesë këmbimi, pajisje elektroshtëpiake, produkte elektrike, goma, vegla pune etj.;
- Organizimi i një rrjeti njësisht tregtare dhe riparuese të cilat do ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me veprimtarinë kryesore;

Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakut të vetëm sipas kushteve për ndryshimin e Statutit.

Neni 4
Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat. Ajo mund shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfardo lloj shkaku.

Neni 5
Kapitali i Shoqërisë

Shoqëria tregtare "RENTIUM" SH.P.K do të fillojë veprimtarinë e saj me një kapital themeltar prej 100000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital përbën 1(një) kuotë me vlerë nominale 100000 (njëqind mijë) lekë

Neni 6
Drejtimi i Shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, **Znj. Ana Kotte**, shtetas Shqiptar, lindur më **01.12.1994**, në Tiranë, Shqipëri, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i pasaportes me numer BD9516708 me numer personal **J46201052S**, me adresë Rr. "Vaso Pasha", Nd. 17, H. 9, Ap. 26, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë. Ai është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj. Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

Neni 7
Të ardhurat

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut të vetëm të shoqërisë.

Neni 8
Emërimet

Ortaku themelues ka të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjerë, ka të drejtë të caktojë financiarë, likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë.

Neni 9
Zgjidhja e konflikteve

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 10
Vula e shoqërisë

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

Akti i themelimit u përpilua në 4 (katër) kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "RENTIUM" SH.P.K.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

Znj. Ana Kotte

Ana Kotte

ORTAKU I VETËM THEMELUES

"RENTIUM" SH.P.K